



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

PLANI I PUNËS
SË
BORDIT DREJTUES Nr. IV TË
SHSKUK-së

Prishtinë, JANAR 2024

PËRMBAJTJA.....	2
SHKURTESAT.....	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
2. HYRJE.....	7
3. PASQYRË E PËRGJITHSHME E SHSKUK-së.....	9
3.1 Korniza Ligjore.....	9
3.2 Përshkrimi i SHSKUK-së.....	10
4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE.....	12
5. PLANI I PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË SHSKUK-së PËR VITIN 2024.....	17
• Objektivi I: Shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta.....	17
• Objektivi II: Shërbimet financiare dhe administrative.....	18
• Objektivi III: Shërbimet arsimore dhe kërkimore – shkencore.....	19

▪ 5.1 OBJEKTIVI I: SHËRBIME SHËNDETËSORE CILËSORE DHE TË SIGURTA

5.1.1 Rezultati 1. Shfrytëzueshmëria e shtretërve spitalor (ShShS “BOR”) është përmirësuar.....	17
5.1.2 Rezultati 2. Mesatarja e ditëve të qëndrimit (MDQ “ALOS”) është përmirësuar.....	17
5.1.3 Rezultati 3. Numri i vizitave është rritur.....	17
5.1.4 Rezultati 4. Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve spitalore.....	17
5.1.5 Rezultati 5. Rezistenca antimikrobike është zvogëluar.....	17
5.1.6 Rezultati 6. Furnizimi i qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe materiale harxhuese mjekësore.....	17
5.1.7 Rezultati 7. Reduktimi i listës së pritjes së pacientit.....	17
5.1.8 Rezultati 8. Numri i referimeve për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore është zvogëluar.....	17
5.1.9 Rezultati 9. Shfrytëzueshmëria e BNJ (burimeve njerëzore) është rritur.....	18
5.1.10 Rezultati 10. Furnizimi i pajisjeve mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre funksionale.....	18
5.1.11 Rezultati 11. Referimet nga niveli dytësor dhe parësor janë zvogëluar.....	18
5.1.12 Rezultati 12. Numri i shërbimeve i raportuar.....	18
5.1.13 Rezultati 13: Avancimi i shërbimeve të reja të krijuara në vitet e kaluara dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.....	18

5.1.14 Rezultati 14. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës spitalore.....	18
5.1.15 Rezultati 15. Digjitalizimi i sistemeve në kuadër të disa shërbimeve në QKUK (në bashkëpunim me MSh).....	18
5.1.16 Rezultati 16. Kontrolli sistematik mjekësor i stafit të ShSKUK-së.....	18

▪ **5.2 OBJEKTIVI II: SHËRBIMET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE**

5.2.1 Rezultati 1. Plani zhvillimor i hartuar	18
5.2.2 Rezultati 2. Plani vjetor i punës së ShSKUK i hartuar.....	18
5.2.3 Rezultati 3. Reformat administrative të zbatuara.....	18
5.2.4 Rezultati 4. Menaxhim efikas, rritje e transparencës dhe llogaridhënies, administrim efikas.....	18
5.2.5 Rezultati 5: Plani i detajuar për reagim emergjent nga ShSKUK i hartuar.....	18
5.2.6 Rezultati 6. Plani për NJAB i zbatuar.....	18
5.2.7 Rezultati 7. Plani i prokurimit i zbatuar.....	18
5.2.8 Rezultati 8. Buxheti i shpenzuar sipas LMFP.....	18
5.2.9 Rezultati 9. Lista e rrezikut e aprovuar.....	18
5.2.10 Rezultati 10. Raportimi i rregullt dhe periodik është realizuar.....	18

▪ **5.3 OBJEKTIVI III: SHËRBIMET ARSIMORE DHE KËRKIMORE – SHKENCORE**

5.3.1 Rezultati 1. aktivitetet arsimore të zbatuar.....	19
5.3.2 Rezultati 2. aktivitete shkencore të realizuara.....	19

6. Aneksat

<i>6.1 Tabela 1: Korniza Logjike e Planit të Punës së Bordit.....</i>	<i>19</i>
<i>6.2 Biografi e shkurtër e anëtarëve të Bordit Drejtues të SHSKUK-së.....</i>	<i>19</i>

SHKURTESAT:

BB	Banka Botërore
BNj	Burime njerëzore
EVM	Edukimi i vazhdueshëm mjekësor
FAM	Fertilizimi i asistuar mjekësor
KDSH	Kujdesi dytësor shëndetësor
KTSh	Kujdesi tretësor shëndetësore
MDQ	Mesatarja e ditëve të qëndrimit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
PSO	Procedura standarde operative
PV	Plani i veprimit
RKS	Republika e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SISh	Sistemi i informimit shëndetësor
SMSF	Sistemi i menaxhimit të stokut farmaceutik
SP	Spital i përgjithshëm
ShSKUK	Shërbimi Klinik Spitalor dhe Universitar i Kosovës
ShShS	Shfrytëzueshmëria e shtretërve spitalor
ZhVP	Zhvillim i vazhdueshëm profesional

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Punës së Bordit Drejtues Nr. IV të SHSKUK-së kryesisht është bazuar në sfidat e identifikuara nga Raportet vjetore paraprake të punës së SHSKUK-së.

Prioritetet e përcaktuara fokusohen në orientimin e përgjithshëm për zhvillimin e SHSKUK si dhe reagimit optimal ndaj nevojave shëndetësore të qytetarëve për kujdesin dytësor dhe tretësor brenda kompetencave të SHSKUK, realizimin e aktiviteteve të ndërlidhura financiare dhe administrative si dhe fuqizimin e aktiviteteve arsimore dhe kërkimore – shkencore.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të ofruara për qytetarë si dhe rritjes së kënaqshmërisë së pacientëve për shërbimet të cilat i marrin, janë përcaktuar edhe objektivat të cilat synohen të arrihen;

PLANI PËRMBAN TRE (3) OBJEKTIVA:

- **Shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta,**
- **Shërbimet e qëndrueshme financiare dhe administrative dhe**
- **Shërbimet arsimore dhe kërkimore – shkencore.**

Të njëjtat synohen të arrihen përmes 28 rezultateve të cilat ndërlidhen me; furnizimin e qëndrueshëm dhe të rregullt me barna dhe materiale harxhuese mjekësore, reduktimin e listës së pritjes së pacientit, kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve spitalore, avancimin e shërbimeve të reja të krijuara në vitet e kaluara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore, menaxhim efikas, rritje të transparencës dhe llogaridhënies, administrim efikas, furnizim me pajisje mjekësore, servisim dhe mirëmbajtje të tyre funksionale, përmirësim dhe zgjerim të infrastrukturës spitalore, digjitalizim të sistemeve në kuadër të disa shërbimeve në QKUK (në bashkëpunim me MSh), përgatitja të Planit për reagim emergjent, kontrolli sistematik mjekësor të stafit të SHSKUK-së si dhe reformat administrative, ngritjen e performancës në Njësit Organizative të SHSKUK-së, nxjerrjen e akteve të brendshme, ngritjen e menaxhimit, nxjerrjen e

listës së shërbimeve shëndetësore dhe çmimorën e tyre, Listën e Barnave Esenciale konform buxhetit të aprovuar, shqyrtimin e raporteve të punës, zgjedhjen e udhëheqësit të NJAB të

SHSKUK-së, shqyrtimin e raporteve të NJAB, ristrukturimit (miratimit të përfitimit, shkrirjes, ndarjes dhe shpërbërjes) të Njësive Organizative të SHSKUK-së, caktimit të bartësit të shërbimit profesional dhe TeR (Përcakton bartësin e Shërbimit të caktuar Profesional përfshirë njësitë përbërëse të institucionit shëndetësor – njësi organizative e ShSKUK, në bazë të propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm), planeve zhvillimore dhe strategjitë financiare, monitorimit dhe këshillimit të Njësive Organizative të SHSKUK-së që të respektojnë kriteret e përcaktuara në strategjitë financiare në mënyrë që të mos hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me rrezik të panevojshëm financiar, vlerësimit dhe mbikëqyrjes së rekomandimeve të Shërbimeve Profesionale për organet udhëheqëse të institucioneve shëndetësore – njësi organizative të ShSKUK, përkitazi me mundësitë e pranimit të kuadrit plotësues profesional ose prokurimit plotësues të pajisjeve mjekësore dhe produkteve medicinale, në rastin e afarizmit të tyre pozitiv financiar.

Aktivitetet e planifikuara për arritje të rezultateve të synuara varen nga mundësitë buxhetore në dispozicion të pasqyruara në buxhet.

2. HYRJE

Shërbimi Klinik Spitalor dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion i themeluar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa Statuti i Shërbimit Klinik Spitalor dhe Universitar të Kosovës është miratuar në mbledhjen e 180-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 29/180, datë 27.12.2023.

Themelimi i SHSKUK-së është specifikuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Paragrafi i parë i këtij neni thekson se SHSKUK themelohet si institucion shëndetësor publik autonom dhe i pavarur, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë.

SHSKUK ushtron veprimtarinë dhe përmbush obligimet dhe detyrat në pajtim me normat, standardet, strategjitë dhe politikat e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Gjithashtu ky institucion ka për detyrë që të ofrojë shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor duke synuar performancë, eficiencë dhe efikasitet sa më të lartë të shërbimeve, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi, duke u siguruar që shërbimet e kujdesit shëndetësor të ofrohen me transparencë, të krijojnë efekte të sinergjisë përmes bashkërendimit të shërbimeve të specializuara, të sigurojnë bartjen e dijes dhe përvojës profesionale dhe shkencore dhe në këtë mënyrë të garantojnë nivelin e lartë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha njësitë e tij organizative.

Në Republikën e Kosovës, reformat në sistemin e shëndetësisë orientohen në arritjen e Synimeve Zhvillimore të Qëndrueshme (SZHQ) - Sustainable Development Goals (SDGs). SDGs kanë për qëllim të kontribuojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e qëndrueshme në nivel global duke rënë në pajtim aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore. SDG 3 fokusohet veçanërisht në shëndetësi dhe synon "të sigurojë një jetë të shëndetshme për të gjithë njerëzit, të gjitha moshat dhe të promovojë mirëqenien e tyre". Këtë synim e ndanë edhe Ministria e Shëndetësisë me Vizionin e saj për shëndetin e popullatës.

VIZIONI: Popullatë e shëndetshme.

Bashkimi Evropian ka vendosur SZHQ-të si një agjendë politike dhe dëshiron t'i realizojë ato deri në vitin 2030. Principi qëndron në faktin se të gjitha vendet, pavarësisht nga nivel i tyre i zhvillimit, duhet të zhvillojnë strategjitë e tyre kombëtare për të arritur qëllimet e SZHQ-së. Në Republikën e Kosovës, Bashkimi Evropian e mbështet reformën në sistemin e shëndetësisë për të arritur SZHQ-3. BE-ja bashkëpunon ngushtë me MSH, autoritetet lokale dhe aktorët relevant të tjerë për të mbështetur misionin, i cili përfshinë forcimin e sistemit shëndetësor, përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe promovimin e sjelljeve të shëndetshme.

MISIONI: Ofrimi i shërbimeve cilësore e të sigurta për të gjithë qytetarët e vendit.

Misioni dhe vizioni i këtij dokumenti do të arrihen me plotësimin e dy objektivave strategjike, të cilat janë:

OBJEKTIVA I: Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime shëndetësore

OBJEKTIVA II: Ruajtja dhe përparimi i shëndetit.

Vizioni i SHSKUK-së është që të jetë institucion shëndetësor i njohur për nga cilësia e shërbimeve të ofruara, me pacientin dhe familjen e tij në qendër të procesit të kujdesit shëndetësor, rezultat i një sistemi të organizuar i bazuar në vlera dhe udhëheqje të parimeve si: barazia, gjithë përfshirja, cilësia, ndershmëria dhe llogaridhënia, solidariteti dhe mos-diskriminimi, përderisa mision i këtij Institucioni është që SHSKUK të jetë institucion dinamik i fokusuar në progres dhe përsosmëri në të gjitha fushat e veprimtarisë që të mund të ofrojë kujdes shëndetësor sa më cilësor për pacientët, në përputhje me trendët e mjekësisë moderne, i aftë për transformim dhe riorganizim të shpejtë duke iu përgjigjur nevojave dhe emergjencave shëndetësore lokale e globale.

3. PASOYRË E PËRGJITHSHME E SHSKUK-së

3.1 KORNIZA LIGJORE

Në mbështetje të Nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 63 Paragrafët 2 dhe 3 dhe Nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi është krijuar SHSKUK-ja si dhe ka derivuar Statuti si akt nënligjor.

Neni 14, Bordi Drejtues është organ kolegjal i cili drejton SHSKUK-në dhe është organi më i lartë vendim-marrës i SHSKUK-së dhe ky trup i përgjigjet dhe i jep llogari Qeverisë nëpërmjet Ministrit të Shëndetësisë.

Në Nenin 15, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Bordit Drejtues janë:

- 1.1. Përcaktimi i planit zhvillimor institucional të ShSKUK-ës, përfshirë përcaktimin e misionit, vizionit dhe objektivave të ShSKUK-ës, si dhe miratimi i planeve operacionale për arritjen e këtyre objektivave;
- 1.2. Miratimi i buxhetit dhe pasqyrave financiare;
- 1.3. Monitorimi i performancës financiare dhe sigurimi që burimet financiare ndahen në përputhje me nevojat nga mbledhja e fondeve me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të ShSKUK-ës;
- 1.4. Mbështetja e Ministrisë së Shëndetësisë në zhvillimin dhe miratimin e politikave që drejtojnë funksionimin e shërbimeve shëndetësore, kujdesin ndaj pacientit, sigurinë dhe aspekte të tjera të ofrimit të kujdesit shëndetësor;
- 1.5. Propozimi dhe rishikimi i politikave dhe procedurave për qeverisjen e ShSKUK -së, përfshirë zhvillimin dhe miratimin e akteve të përgjithshme të cilat nuk janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë, kodeve të sjelljes dhe dokumenteve të tjera qeverisëse;

- 1.6. Sigurimi i cilësisë së lartë të kujdesit dhe sigurisë së pacientit përmes mekanizmave për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të ofruara të kujdesit shëndetësor si dhe respektimi i standardeve etike në ofrimin dhe kërkimin e kujdesit shëndetësor;
- 1.7. Emërimi, mbikëqyrja, lirimi nga detyra dhe vlerësimi i performancës të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-ës, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.8. Sigurimi që ofruesit e shërbimeve shëndetësore janë të përgatitur për emergjencat dhe fatkeqësitë dhe miratimi i planeve të gatishmërisë emergjente;
- 1.9. Propozimi i plotësim ndryshimit të e Statutit të ShSKUK-ës, statuteve të njësive përbërëse, si dhe krijimi, shkrirja, ndarja dhe shpërbërja e njësive përbërëse të ShSKUK-ës në përputhje me nevojat e qytetarëve për shërbime shëndetësore, kriteret e performancës dhe efikasitetit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin;
- 1.10. Nxjerrë dhe miraton aktet e brendshme për organizimin e klinikave të QKUK-së;
- 1.11. Propozimi dhe miratimi i partneriteteve strategjike me organizata të tjera të kujdesit shëndetësor, universitete ose institucione kërkimore, varësisht nga nevojat e ShSKUK-ës;
- 1.12 . Raportimi i rregullt vjetor dhe tre mujor së bashku me deklaratën financiare dhe raportet e auditimit mbi aktivitetin e ShSKUK-ës për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë.

3.2 PËRSHKRIMI I SHSKUK-së

SHSKUK-ja përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik si në vijim :

- 1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
- 1.2. Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës;
- 1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive;
- 1.5. Qendra e Telemjekësisë së Kosovës;
- 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;

- 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan;
- 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
- 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
- 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
- 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
- 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;
- 1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpi për Integrim në Komunitet; (Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren, Pejë dhe Gjakovë);
- 1.14. Qendra për Integrim dhe Rehabilitim të Pacientëve Kronikë Psikiatrik në Shtime.
- 1.15. Poliklinikat specialistike stomatologjike.

4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE

Referuar studimit të fizibilitetit për përmirësimin e infrastrukturës fizike të institucioneve të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar” i cili është i aprovuar me 02.06.2021 nga Ministri i Shëndetësisë dhe i njëjti studim u përditësua dhe u aprovua me datë 26 tetor 2022 nga Ministria e Shëndetësisë, studim ky i cili ishte realizuar në vitin 2019.

Referuar planit vjetor të punës të SHSKUK-së për vitin 2022 (QKUK dhe Spitalet e Përgjithshme) në përgjithësi ka një performancë jo të mirë referuar indikatorëve kyç të performancës (si numrin e pacientëve të shtrirë, operacionet, vizitat ambulantore, shërbimet laboratorike, dhe radiologjike, numrin e dializave, shërbimet tjera diagnostike, shërbimet tjera të veçanta, dhe shfrytëzueshmërin e kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit), ku kohëzgjatja mesatare e shërimit është 5.1, dhe shfrytëzimi i kapaciteteve është 56% në nivel të SHSKUK.

Ndërsa referuar draft raportit gjashtëmuor të punës së SHSKUK-së (Janar- Qershor 2023) të dhënat e indikatorëve kyç të performancës nuk kanë diferencë nga raporti i punës se vitit 2022, pasi që mesatarja e ditëve të shërimit për pacient në SHSKUK gjatë periudhës Janar- Qershor 2023 është 5.1 ditë, ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve të SHSKUK-së është 58%.

Sipas raportit të punës në periudhën Janar-Dhjetor 2022 në spitalet e përgjithshme, mesatarja e ditëve të shërimit për pacient është 4.1 ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve është 43%.

Ndërsa draft raportin gjashtëmuor të SHSKUK-së (Janar- Qershor 2023) në spitale të përgjithshme mesatarja e ditëve të shërimit për pacient është 4.2 ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve të është 46%. Nëse krahasojmë me periudhën e njëjtën kohore të vitit 2022 mesatarja e ditëve të shërimit për pacient ishte 4.3 ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve është 44%, pra gjendja është thajse e njëjtë sa i përket shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve.

Pra, të dhënat e indikatorëve kyç të performancës nuk kanë diferencë pozitive referuar raporteve të cituara më lartë.

Sipas të dhënave repartet e spitaleve të përgjithshme ku mesatarja e ditëve të qëndrimit është mbi 5 ditë dhe shfrytëzueshmëria është nën 20%, janë reparte të paraqitura në tabelën nr.1:

Njësia	Reparti	Numri i shtretërve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	BOR	ALOS
Spitali Pejë	Ortopedisë	29	1,770	283	34%	6.3
	Urologjisë	18	1,667	327	51%	5.1
	Oftalmologjisë	10	769	76	43%	10.1
	Internistikës	42	6,772	918	90%	7.4
	Infektivës	14	977	113	39%	8.6
	Neurologjisë	24	1,451	244	34%	5.9
	Psikiatrisë	16	1,386	80	48%	17.3
	Krahorit	28	2,326	242	46%	9.6
Spitali Ferizaj	Pediatrik	12	1,563	234	72%	6.7
	Internistik	15	2,224	273	82%	8.1
Spitali Vushtrri	Pediatria	13	1,344	196	57%	6.9
	Interno	10	1,673	246	93%	6.8
Spitali Mitrovicë	Ortopedi	13	1,334	260	57%	5.1
	ORL	12	1,058	129	49%	8.2
	Infektiva	6	376	61	35%	6.2
	Neurologji	12	1,144	231	53%	5.0
	Pulmologjia	10	1,532	150	85%	10.2
Spitali Gjakovë	Urologjia	22	1,223	245	31%	5.0
	ORL	9	684	93	42%	7.4
	Neurologjia	24	1,395	271	32%	5.1
	Psikiatria	26	2,044	99	44%	20.6
	Pulmologjise	24	2,141	315	50%	6.8
	Kujdesi Intenziv	10	612	82	34%	7.5
Spitali Prizren	Ortopedia	27	2,242	355	46%	6.3
	ORL	24	3,453	638	80%	5.4
	Oftalmo	16	1,690	227	59%	7.4
	Pediatria	48	5,332	1,050	62%	5.1
	Internistik	56	5,401	899	54%	6.0
	Neurologjia	20	1,324	226	37%	5.9
	Psikiatria	20	909	112	25%	8.1
	Krahnori	45	3,407	350	42%	9.7
	Kujdesi Intenziv	8	597	103	41%	5.8
Spitali Gjilan	Ortopedia	19	1,863	217	54%	8.6
	Urologjia	20	702	121	20%	5.8
	Pediatria	28	1,004	340	20%	3.0
	Internistik	59	5,233	931	49%	5.6
	Infektiva	28	1,219	222	24%	5.5
	Neurologjia	11	851	143	43%	6.0
	Psikiatria	15	1,315	60	49%	21.9
	Krahnori	26	3,496	295	75%	11.9
	Kujdesi Intenziv	13	286	1,037	12%	0.3

Tabelë 1, Repartet e spitaleve të përgjithshme ku mesatarja e ALOS është mbi 5 ditë dhe BOR është nën 20% Janar-Qershor 2023

Ndërsa shfrytëzueshmeria e kapaciteteve dhe mesataren e ditëve të shërimit në repartet ORL dhe Oftalmo ku funksionojnë në 5 spitale të përgjithshme, janë raportuar këto të dhëna të paraqitura më poshtë në *TABELË NR. 2*.

Njesia	Reparti	Numri i shtretërve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	BOR	ALOS
Spitali Peje	ORL	19	921	196	27%	4.7
	Oftalmo	10	769	76	43%	10.1
Spitali Mitrovice	ORL	12	1,058	129	49%	8.2
	Oftalmo	12	747	231	35%	3.2
Spitali Gjakove	ORL	9	684	93	42%	7.4
	Oftalmo	6	190	96	18%	2.0
Spitali Prizren	ORL	24	3,453	638	80%	5.4
	Oftalmo	16	1,690	227	59%	7.4
Spitali Gjilan	ORL	12	2,068	344	96%	6.0
	Oftalmo	3	69	16	13%	4.3

Table 1, Shfrytëzuesmëria dhe mesatarja e ditëve të shërimit në repartet e ORL dhe Oftalmo-Janar-Qershor 2023

Kurse tek shërbimeve imazherike në nivel të SHSKUK, gjatë periudhës Janar-Qershor 2023 sipas draft raportit të punës së SHSKUK, ishin kryer gjithsejtë 195,701 si CT, MRI, Ultrazë, Radiografi, DSA angiografi, TK angiografi, Mamografi, Sintigrafi, Densitometria e kockave, etj. Nëse krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2022 gjendja është thuajse e njëjtë me një ngritje të përgjithshëm të shërbimeve vetëm 1%. Ndërsa sa i përket shfrytëzueshmerisë së aparaturave njerëzore për secilën pajisje ka mungesë të të dhënave të duhura.

Gjatë viteve të fundit, ofrimi i barnave dhe materialeve tjera harxhuese mjekësore është stabilizuar në masë të konsiderueshme, përderisa sfidë e identifikuar e cila do të adresohet gjatë vitit 2024 është nevoja për fuqizim të mekanizmave për monitorimin e shpenzimit të barnave duke shfrytëzuar dhe siguruar funksionimin e plotë të SMSF.

Edhe përkundër reduktimit të listave të pritjes gjatë viteve 2022 dhe 2023 si dhe referimeve të gjithë pacientëve për mjekim jashtë institucioneve shëndetësore publike, sfidë ende mbeten listat e gjata të pritjes për disa shërbime, situatë kjo në të cilën kanë ndikuar edhe listat e gjata të pritjeve të krijuara ndër vite.

Infeksionet e marra nga spitali janë ende sfidë dhe paraqesin një problem serioz që duhet trajtuar menjëherë. Mungesa e filtrave në sallat e operacionit, mungesa e uniformave dhe këpucëve adekuate për stafin e sallave të operacionit, mungesa e Procedurave Standarde Operative (PSO) veçmas për njësitë e kujdesit intensiv dhe blloqet operative, furnizimet e pamjaftueshme me mjete higjienike dhe dezinfektuese janë disa nga mangësitë që pritet të shmangen gjatë këtij viti.

Duke pas parasysh nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore, edhe pse është investuar në infrastrukturë dhe pajisje, ende ekziston nevoja e avancimit të shërbimeve ekzistuese por edhe funksionalizimit të shërbimeve të reja me tendencë të përcjelljes së trendëve botërore sipas standardeve ndërkombëtare.

Llogaridhënia dhe rritja e transparencës është ende në nivelin jo të kënaqshëm, parime këto bazë nga të cilat duhet të udhëhiqet një organizatë. Drejtuesit e çdo njësie organizative të SHSKUK-së dhe secilit nivel hierarkik nuk kanë ofruar gjithmonë mbajtje të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për punën e tyre.

Edhe pse viteve të fundit është investuar mjaft në pajisje mjekësore për shumë Njësi Organizative të SHSKUK-së, megjithatë, nevoja për pajisje tjera mjekësore, sigurimi i pajisjeve mjekësore të avancuara vazhdon të mbetet ende evidente. Gjithashtu, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre e rregullt është një sfidë që kërkon përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm të personelit profesional shëndetësor dhe mbështetës. Duke konsideruar kohën e ndërtimit të objekteve spitalore në QKUK si dhe në Spitalet e përgjithshme, vazhdimisht është e nevojshme ndërhyrje për të mirëmbajtur dhe përmirësuar infrastrukturën e tyre. Përveç kësaj, edhe nevoja për objekte të reja shëndetësore brenda SHSKUK-së është më se evidente me qëllim të përcjelljes së trendëve bashkëkohore dhe zhvillimeve në sektorin e shëndetësisë.

Mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse në nivel vendi është evidente dhe paraqet sfidë serioze, në veçanti në hartimin e politikave shëndetësore të bazuara në dëshmi. Andaj, sa i përket adresimit të sfidave të identifikuara për funksionalizim të një sistemi të integruar dhe gjithëpërfshirës të sistemit të informimit shëndetësor, MSh ka përfunduar studimin e fizibilitetit për zhvillimin e SISh në nivel kombëtar dhe ka hartuar dokumentin strategjik dhe planin e veprimit në përputhje me rekomandimet e dala nga studimi i fizibilitetit. Aktualisht, MSh është duke negociuar me Bankën

botërore (BB) lidhur me financimin e projektit për shtrirje dhe funksionalizim të SISh-it në të gjitha institucionet shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Mësimet e nxjerra nga pandemia e fundit me COVID-19, kanë shpërfaqur nevojën e përgatitjes së planeve për reagim të institucioneve në situata emergjente gjë që do të siguron koordinim të aktiviteteve të njësive përbërëse të SHSKUK në parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje.

Janë identifikuar edhe sfida në funksionim të administratës dhe nevojës për reformim të strukturave organizative. Rolet dhe përgjegjësitë institucionale dhe individuale jo mirë të definuara kanë ndikuar në organizimin jo të kënaqshëm të ofrimit të shërbimeve për qytetarët në nevojë.

5. PLANI I PUNËS SË BORDIT DREJTUES Nr. IV TË SHSKUK-së

Plani i punës së Bordit Drejtues të SHSKUK-së bazohet në prioritetet që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore në përputhje me kapacitetet buxhetore të SHSKUK-së të pasqyruara në buxhet.

Prioritetet e përcaktuara fokusohen në orientimin e përgjithshëm për zhvillimin e SHSKUK-së si dhe reagimit optimal ndaj nevojave shëndetësore të qytetarëve për kujdesin dytësor dhe tretësor brenda kompetencave të SHSKUK, realizimin e aktiviteteve të ndërlidhura financiare dhe administrative si dhe fuqizimin e aktiviteteve arsimore dhe kërkimore – shkencore.

Bordi Drejtues Nr.IV do të realizon numër të mbledhjeve në përputhje me Rregulloren e Punës së Bordit Drejtues të SHSKUK-së.

Bordi Drejtues në funksion të realizimit të obligimit për të siguruar mbarëvajtjen e gjithmbarshme të SHSKUK-së si dhe reagimin optimal ndaj nevojave shëndetësore të qytetarëve për KDSH dhe KTSh synon të arrijë rezultatet si në vijim:

5.1 OBJEKTIVI I: SHËRBIME SHËNDETËSORE CILËSORE DHE TË SIGURTA

REZULTATET E OBJEKTIVIT TË PARË:

1. Shfrytëzueshmëria e shtretërve spitalor (ShShS “BOR”) është përmirësuar,
2. Mesatarja e ditëve të qëndrimit (MDQ “ALOS”) është përmirësuar,
3. Numri i vizitave është rritur,
4. Infeksionet spitalore janë zvogëluar (Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve të marra nga spitali),
5. Rezistenca antimikrobike është zvogëluar,
6. Furnizimi qëndrueshëm dhe i rregullt me barna dhe materiale mjekësore është siguruar,
7. Listat e pritjes janë reduktuar - synohet heqja e listave të pritjes,
8. Numri i referimeve për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore është zvogëluar,

9. Shfrytëzueshmëria e BNJ (burimeve njerëzore) është rritur,
10. Shfrytëzueshmëria e aparaturave mjekësore është optimizuar (Furnizimi i pajisjeve mjekësore, servisimi dhe mirëmbajtja e tyre funksionale),
11. Referimet nga niveli dytësor dhe parësor janë zvogëluar/racionalizuar,
12. Numri i shërbimeve i raportuar,
13. Shërbimet shëndetësore janë të krijuara dhe avancuara Janë krijuar shërbime të reja dhe janë avancuar shërbimet ekzistuese (Avancimi i shërbimeve të reja të krijuara në vitet e kaluara dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore),
14. Infrastruktura spitalore është zgjeruar dhe përmirësuar,
15. Sistemet në kuadër të disa shërbimeve në QKUK janë digjitalizuar (në bashkëpunim me MSh),
16. Kontrolli sistematik mjekësor i stafit të SHSKUK-së është realizuar.

5.2 OBJEKTIVI II: SHËRBIMET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

REZULTATET E OBJEKTIVIT TË DYTË:

1. Plani zhvillimor i hartuar (Fushat ne te cilat kemi ngecje, vendimmarrja në kompetencat kryesore menaxheriale të defnuara qartë, qëndrueshmëria financiare (3 vjeçar)),
2. Plani vjetor i punës së SHSKUK-së i hartuar (Derivimi i aktiviteteve),
3. Reformat administrative të zbatuara (riorganizimi, ALOS, BED, Reparte në Poliklinika),
4. Plani i integritetit institucional i hartuar (Menaxhimi efikas, rritje e transparencës dhe llogaridhënies për administrim efikas),
5. Plani i detajuar për reagim emergjent nga SHSKUK-ja i hartuar (Përshtatja),
6. Plani për NJAB i zbatuar,
7. Plani i prokurimit i zbatuar,
8. Buxheti i shpenzuar sipas LMFP,
9. Lista e rrezikut e aprovuar,
10. Raportimi i standardizuar, i rregullt dhe periodik është realizuar (model raporti i MSH -së).

5.3 OBJEKTIVI III: SHËRBIMET ARSIMORE DHE KËRKIMORE – SHKENCORE

REZULTATET E OBJEKTIVIT TË TRETË:

1. Aktivitetet arsimore të zbatuara,
2. Aktivitete shkencore të realizuara.

6. ANEKSET

6.1 Tabela 1: Korniza Logjike e Planit të Punës së Bordit

6.2 Biografi e shkurtër e anëtarëve të Bordit Drejtues të SHSKUK-së